



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:018904
Datë: 17.12.2020
Numri i dokumentit: 01352828

C.nr.169/20

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtarja Florije Qerimi, me bashkëpunëtorin profesional Baki Sylejmani, në çështjen kontestimore të paditësit F. M nga Gjilani, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati Enver Halili nga Gjilani, ndaj të paditurës Komuna e Gjilanit – Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilani, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson përfaqësuesi i saj ligjor B. M... nga Gjilani, me objekt kontesti, kompensimin e shpërblimit jubilar dhe kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor e publik, më datën 15.12.2020 mori këtë:

AKTGJYKIM

I.APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit F. M nga Gjilani dhe OBLIGOHET e paditura që paditësit F. M nga Gjilani, t’ia paguaj në emër të shpërblimit jubilar shumën prej 315.75 €, si dhe në emër të kompensimit të ushqimit për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri më datën 31.01.2020, në shumë prej 988.00 € (për 494ditë pune), respektivisht shumën e përgjithshme prej 1,303.75 € (një mijë e tre qindë e tre euro e shtatëdhjetë e pesë centë), me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga dita e pranimit –dorëzimit të këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive dhe në emër të shpenzimeve të procedurës në shumë prej 260,00 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m i

Fillimisht paditësi në këtë gjykatë më datë 10.02.2020, përmes të autorizuarit të tij, ka ushtruar padi kundër të paditurës, me të cilën ka kërkuar që të aprovet kërkesëpadia e tij dhe të obligohet e paditura që paditësit, t’ia paguaj në emër të kompensimit për ushqim gjatë ditëve punës sipas nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit, shumën e të hollave në lartësi prej 988.00 € (për 494 ditë pune) me kamatë ligjore prej 8% ne vit, duke filluar nga dita e ushtrimit te padisë e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm, ndërsa në shqyrtimin kryesortë datës

15.12.2020 ka bërë precizimin e padisë ashtu që tani kërkon edhe pagesën shpërblimit jubilar për mbi 20 vite përvojë pune edhe ate shumën e të hollave prej 313.75 €.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore pas shqyrtimit paraprak të padisë ka nxjerr aktvendimin për përgjigje në padi më dt.26.02.2020, ku e paditura aktvendimin së bashku me padinë e ka pranuar më datën 27.02.2020 e cila datë është konfirmuar përmes fletëkthesës së gjykatës. Me aktvendimin për përgjigje në padi, gjykata e ka njoftuar të paditurën për detyrimin ligjor për dhënie të përgjigjes në padi dhe për pasojat ligjore që do t'i ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi, për mundësin që gjykata të marrë aktvendim për shkak të mosbindjes.

E paditura në përgjigje në padi e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit për arsye se paditësi kërkesëpadinë e saj e bazon në Kontratën e Përgjithshme Kolektive të Kosovës e miratuar dhe e nënshkruar nga MASHT(M. e A., Sh., dhe T) dhe SBASHK(S. B. e A, Sh. dhe K.), respektivisht në dispozitat e nenit 35 pika 8 dhe nenit 35 pika 67 të kësaj kontrate, gjersa ka konsideruar se kjo kontratë nuk prodhon efekte juridike dhe nuk krijon të drejta dhe detyrime ndaj Komunës së Gjilanit si e paditur në këtë rast. Po ashtu ka theksuar se kjo kontratë nuk është në fuqi për disa arsye konkrete: Ligji Nr.04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti i datës 06.05.2014 nuk ka paraparë një të drejtë të tillë sipas padisë dhe kërkesëpadisë dhe se çdo marrëveshje që parasheh të drejta jashtë këtij ligji nuk prodhon kurrfar efekti juridik, tutje ka theksuar se kjo kontratë kolektive në hyrje të saj bazohet në Ligjin e Punës i cili nuk parasheh një të drejtë të tillë të beneficioneve, pasi neni 77 i këtij ligji potencon se pensioni i vjetërsisë dhe i parakohshëm rregullohen me ligj të veçantë. Pagat jubilarë sipas Kontraës Kolektive të Arsimit mund të i realizonte pas çdo 10 viteve dhe se afati i realizimit të kësaj kërkesë është 30 ditë nga koha e të drejtës për kompensim, ndërsa në rastin konkret kemi tejkallim të afatit ligjor të realizimit të kësaj kërkesë d.m.th. paditësi nuk e ka kërkuar realizimin e kësaj kërkesë në afat prej 30 ditësh.

I autorizuari i paditësit si në shqyrtimin përgatitor, kryesor ashtu edhe në shpjegime përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë thënieve në padi dhe kërkesëpadi, si dhe precizimit të saj në shqyrtimin kryesor duke kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadija e tij dhe të obligohet e paditura që paditësit F. M nga Gjilani, që t'ia paguaj në emër të shpërblimit jubilar shumën prej 315,75 €, si dhe në emër të kompensimit të ushqimit për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri më dt.31.01.2020, shumën e të hollave në lartësi prej 988.00 € (për 498 ditë pune), respektivisht shumën e përgjithshme prej 1,303.75 €, me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, gjithë këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.Gjithashtu i njëjti i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës edhe atë: për përpilimin e padisë shumën prej 260 €, për taksë gjyqësore shumën prej 21 €, një seancë të mbajtur shumën prej 135 €.

Përfaqësuesi ligjor i të paditurës si në shqyrtimin përgatitor, kryesor ashtu edhe në shpjegimet përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë përgjigjes në padi duke e

kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, ndërsa sipas Ligjit për Marrëdhënie të Detyrimeve Ligjin.Nr.03/L-212 i punës neni 87 në rastin konkret kemi parashkrim të kërkesës për arsye se sa i përket pagës jubilarë neni 353 par. 3 dhe neni 357 par.1 si dhe sipas Ligjit të Punës neni 87 kemi parashkrim të kërkesës, ngase paditësi i ka mbi 29 vite të punës ndërsa dihet se një e drejtë e tillë i ka takuar, pasi që paditësi ka dal në 20 vite të përvojës së punës, që do të thotë se një kërkesë e tillë e ka bërë pas 9 viteve ku e gjithë kjo vërtetohet përmes vërtetimit të lëshuar nga .Andaj në fund ka kërkuar nga gjykata që kërkesëpadia e paditësit për pagesën e shpërblimit jubilar të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata për të vepruar drejtë dhe për ti vërtetuar pretendimet e palëve ndërgjyqëse në këtë çështje kontestimore ka administruar dhe vlerësuar këto prova materiale:Kontratën e Punës për Mësimdhënës në kohë të pacaktuar me nr.Prot. ... datës 01.09.2015; Kërkesa për kompensimin e punëtorëve e drejtuar Komunës së Gjilanit-DKA, e ushtruar nga përfaqësuesi i paditësit; Lista e pagave e lëshuar nga Buxheti i RK-së për muajin janar 2020; Vendimi nga SHFMU në Gjilan, me nr.... e dt. 27.07.2020; dhe Aktvendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës sipas fuqisë së Ligjit me nr.... i datës 28.01.2020, lëshuar nga DKA në Gjilan.

Pas vlerësimit me kujdes të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku si në kuptim të nenit 8 të LPK-ës si dhe në bazë të rezultatit të gjithëmbarshtëm të procedurës kontestimore, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se paditësi F. M ka filluar punën në SHFMU në Gjilan, në pozitën e mësimdhënësit që nga data 02.11.1999 e deri më dt. 06.02.2020, kur të njëjtit i është ndërprerë marrëdhënia e punës sipas fuqisë së Ligjit pasi që ka mbushur moshën 65 vjeçare, fakt ky i vërtetuar nga Aktvendimi për Ndërprerjen e Marrëdhënjes së Punës sipas fuqisë së Ligjit.

Nga kontrata e Punës për mësimdhënës në kohë të pacaktuar me nr. Prot... Gjykata vërtetoi faktin se kjo kontratë është lidhur më datë 01.09.2015 në mes DKA-së në Gjilan, në cilësi të punëdhënësit dhe F. M në cilësi të punëmarrësit.

Nga Lista e pagës për paditësin F. M, gjykata vërtetoi faktin se i njëjti pagën neto e ka marrë 496.32 €, ndërsa paga bazë është 421.00 €

Nga Vërtetimi i SHFMU . me nr.të prot.... i dt.07.01.2020 mbi ditët e pranisë në punë, gjykata vërtetoi faktin se i njëjti nga data18.04.2017 e deri më 31.01.2020 ka gjithsejt 494 ditë pune.

Gjykata në këtë çështje kontestimore sa i përket të drejtës subjektive të paditësit dhe lartësisë së saj, ka zbatuar dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës18.04.2017 e cila ka hyrë në fuqi menjëherë konkretisht nenin 35 par.7 dhe 8 pika 8.2 të kësaj kontrate, ndërsa procedura është zhvilluar në bazë të Ligjit të Procedurës Kontestimore në fuqi.

Gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi që të aprovoj si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit E. K ashtu që e obligoi të paditurën që paditësit t'ia paguaj në emër të shpërblimit jubilar për mbi 20 vite përvojë pune në vlerë të 75% të një page bazë, respektivisht shumën e të hollave në lartësi prej 315.75 €, si dhe në emër të kompensimit të ushqimit për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri më dt.31.01.2020, shumën e të hollave në lartësi prej 988.00 € (për 494 ditë pune), respektivisht shumën e përgjithshme prej 1,303.75 €, me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit e deri në pagesën definitive, gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm. Shumat e aprovuara gjykata u bazua në Kontratën Kolektive të Arsimit Parauniversitar të dt.18.04.2017, ku në nenin 35 par. 8 shprehimisht është përcaktuar se “ *Punëtorët (anëtarët e SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblim jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë: kurse pika 8.2 parasheh “Për 20 vite të përvojës së punës në vlerë të 75% të një page bazë dhe neni 8.5 ku shprehimisht parashihet se “Shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi kur i punësuarit i ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kriterëve përkatëse, ndërsa neni 35 par.7, të po kësaj kontrate ku është përcaktuar se “Të punësuarve, u sigurohen kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë për një ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arismore.Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restaurantit apo kuzhinës, ose në një formë tjetër nuk ka obligim kompensimin për ushqim, në rastin konkret institucionet shkollore nuk e kanë të rregulluar ushqimin përmes restauranteve, andaj edhe e obligoj të paditurën që paditësit t'ia kompensoj edhe shumën e lartëcekur në emër të ushqimit.*

Lidhur me pretendimet e të paditurës se në rastin konkret kemi parashkrim të kërkesës, gjykata nje pretendim të tillë e refuzoi me arsyetimin se paditësi ka arritur moshën e pensionimit sipas fuqisë ligjore me datë 06.02.2020, ndërsa padinë në gjykatë e ka paraqitur me datën 10.02.2020, çka do të thotë se në afatin e paraparë ligjor konform dispozitave të nenit 87 i Ligjit të Punës i cili në mënyrë shprehimore ka paraparë se “*Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej tri vitesh nga dita e paraqitjes së kërkesës*”, për më tepër i njëjti ka kërkuar shpërblimin jubilar për 20 vite përvojë pune edhe ate nga data 02.11.1999 e deri më datën 06.02.2020 të njëjtit i ka përfunduar marrëdhënia e punës sipas fuqisë së ligjit dhe më datën 02.11.2019 i ka mbushur 20 vite përvojë pune të pa ndërprerë dhe në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me institutin e parashkrimit i cili nënkupton humbjen e të drejtës për ta relizuar detyrimin në rrugë gjyqësore, andaj në rastin konkret nuk kemi parashkrim të kërkesës sa i përket shpërblimit jubilar.

Po ashtu për gjykatën është i pabazuar edhe pretendimi tjetër i të paditurës se Kontrata Kolektive e Arsimit Parauniversitar nuk prodhon efekt për të paditurën, ngase një pretendim i tillë është në kundërshtim me Ligjin për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës me nr... ku në nenin 5 të këtij ligji janë të parapara kompetencat e komunave

sa i përket punësimit të mësimdhënësve dhe pagesës së tyre e rrjedhimisht edhe detyrimet e parapara me Kontratë bien në barrë të të paditurës.

Kamata ligjore prej 8% në vit është përcaktuar konform nenit 382 të LMD-ës.

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore vendosi konform nenit 452.1 të LPK-ës, që ta obligoj të paditurën që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës edhe atë: për përpilimin e padisë shumë prej 104 €, për taksë gjyqësore shumë prej 21€, për një përfaqësim në seancë shumë prej 135 €, e në shumë të përgjithshme në lartësi prej 260.00€.

Andaj, nga arsyet e cekura më lartë, e konform nenit 143 të LPK-ës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Themelore në Gjiilan, Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.169/20, datë 15.12.2020

Gjyqtarja
Floriqe Qerimi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.